

Informacion

“Mbi blerjen e energjisë elektrike për periudhën 11.03.2015- 20.03.2015”

Në baze të Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 338 date 19.03.2008 “Per miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike” (i ndryshuar), si dhe Vendimit Nr. 130 date 03.12.2014 të Entit Rregullator të Energjisë mbi “Procedurat për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes nga operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike sh.a (OSHEE Sh.a) dhe “Rregullat dhe procedurat e blerjes nga KESH sh.a. të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin Nr.30, date 23.03.2011, të Bordit të Komisionereve të ERE-s, komisioni i Blerjes së energjisë elektrike, në zbatim të urdherit Nr. 4060 prot. date 20.02.2015 të Administratorit të OSHEE sh.a, Z. Adrian Çela me subjekt “Per krijimin e Komisionit të Blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes për periudhën 01.03.2015 – 31.03.2015” në datat 23.02.2015 deri në 25.02.2015, dhe të urdherit nr. 5116 dt. 05.03.2015 për vazhdimin e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes për periudhën 11.03.2015 – 20.03.2015, zhvilloi procedurën e blerjes së energjisë elektrike duke ftuar të marrin pjesë shoqëritë tregtare dhe prodhuese që plotësonin nenin 10 të “Rregullat dhe procedurat e blerjes nga KESH sh.a. së energjisë elektrike, nga tregtarët vendas dhe të huaj” për të paraqitur ofertat e tyre.

Pas dërgimit të ofertave nga shoqëritë tregtare dhe/ose prodhuese, komisioni i blerjes administroi dhe vlerësoi ofertat e paraqitura prej tyre. Shoqëritë që shprehen interes në datën 06.03.2015 janë si më poshtë:

- 1-Shoqëria GEN-I Tirana shpk
- 2-Shoqëria GEN-I Beograd doo
- 3-Shoqëria GEN-I Athens
- 4-Antix sh.p.k
- 5- Shoqëria AXPO d.o.o
- 6- Kurum International sh.a
- 7-Shoqëria GSA shpk
- 8-Shoqëria EFT AG

Më pas komisioni i blerjes vazhdoi procedurat e vlerësimit dhe të negocimit me 8 shoqëritë prodhuese/tregtare që paraqitën interes në procedurën e zhvilluar nga OSHEE sh.a. më datë 06.03.2015 për “Blerje e energjisë elektrike për periudhën 11.03.2015-20.03.2015”.

Në përputhje me vendimin nr.12, dt. 06.02.2015 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s si dhe marrëveshjes nr.prot 2614, dt.06.02.2015 ndërmjet KESH sh.a dhe OSHEE sh.a mbi “Shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a dhe OSHEE sh.a për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, më qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015”, nga përfaqësues të kompanisë KESH sh.a u njoftuam me e-mail në datë 09.03.2015 që KESH sh.a ka mundësi hidroenergjitike të mbulojë gjithë kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. (prej 270MWh) për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes për periudhën 11-20 Mars 2015 nga prodhimi i tij.

Në këto kushte, Drejtoria e Tregtimit të Energjisë, i propozoi administratorit të Kompanisë anulimin e procedurës të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve nga tregu i parregulluar (importi apo prodhuesit privat vendas) për periudhën 11-20 Mars 2015..

Administrator i kompanisë njoftoi subjektet pjesëmarrëse për anulimin e procedurës me anë të njoftimit nr. 5116/11, dt.09.03.2015.

Humbjet per periudhen 11-20 Mars 2015, do te plotesohen nga prodhimi i kompanise KESH sh.a ne perputhje me kushtet e percaktuar ne marreveshjen midis KESH sh.a dhe OSHEE sh.a mbi "Shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a dhe OSHEE sh.a për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, më qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015"

Ky njoftim të botohet në faqen zyrtare të internetit të OSHEE sh.a.

Kryetari i Komisionit

Elton Sevrani